



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:147546

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05477821

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.617/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Spahija në çështjen penale kundër të pandehurit H. F., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1364/22 të datës 22.07.2022, për shkak të veprës penale Ndërtim pa leje nga neni 359 par.2 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 13.03.2024 në prezencë të prokurorit së shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit H. F. me mbrojtësin e tij Av.Kadri Prekaj, me datë 13.03.2024, shpalli dhe me datë 20.03.2024 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

H. F., i lindur me ....., në D., me banim në fsh.D. Komuna Klinë – përkatësisht jetoj dhe punoj në Zvicër, i biri i F. dhe Gj., e gjinisë R., me nr.personal ....., pensionist, i martuar baba i katër fëmijëve, ka te kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas e R-Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Më datë 01.07.2022 rreth orës 11:50, në fshatin Sh.i m. - Rugovë Komuna Pejë, në Parkun Kombëtar, Bjeshkët e Nemuna, në njësinë kadastrale P-....-0...-0, me sip. .... m2, e ndodhur në ZK-Sh. i M., si pronar, ndërton objekt pa leje për të cilin kërkohet leja e tillë në bazë të ligjit për ndërtim dhe atë nenit 7 dhe 14, në atë mënyrë që përderisa hetuesit e Stacionit Policor në Pejë se bashku me zyrtaret nga Ministria Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ishin duke patrulluar, vërejnë se në vendin e lartcekur i pandehuri kishte filluar ndërtimin e një muri rrethues si dhe te një objekti (shtëpi) me material te fortë për të cilin nuk posedon leje përkatëse,

- me këtë ka kryer veprën penale “Ndërtimi pa leje” nga neni 359 paragrafi 2 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42,43, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074):

## GJYKON

Të pandehurit H. F. i shqipton:

- I. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, si dhe dënim me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. RRENOHET objekti i ndërtuar pa leje, i përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, shpenzimet për rrenim i bart i dënuari.
- III. Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

## ARSYETIM

- A. Historiku i çështjes dhe vendimi në lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 20.07.2022 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1364/22 kundër të pandehurit H. F. për shkak të veprës penale Ndërtimi pa leje nga neni 359 par. 2 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 13.03.2024 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku, i pandehuri H. F. me mbrojtësin Av. Kadri Prekaj, në të cilën seancë i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe mbrojtëses se te pandehurit, në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Pas aprovimit të pranimit të fajësisë nga ana e gjykatës, prokurori i shtetit deklaroi “ Me qenë se këtu i akuzuari e pranoj fajësinë konform kushteve ligjore të parapara me nenin 242 të KPPRK-së, nga se pranimin e fajësisë e bëri në mënyrë vullnetare, pa ndikim dhe në mbështetje të fakteve të çështjes që përmban aktakuza, nga Gjykata kërkoj që të njëjtin ta shpall fajtor, ta dënoj sipas ligjit si dhe ta obligoj n paguarjen e shpenzuesve të procedurës penale, ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethanë lehtësues”.

Mbrojtësi i te pandehurit H. F., Av.Kadri Prekaj ne lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit deklaroi: “Siç e cekem pranimin e fajësisë e beri në mënyrë të vullnetshëm, nuk e ka ditë se ndërtimi pa leje është shkelje aq e rëndë, i njëjti e ka bashkëshorten të sëmurë prej zemrës sepse djali i ka vdekë në luftë si dëshmorë dhe si pasoj e asaj dhimbje nëna i ka pësuar edhe këto probleme, mjeku i ka preferuar që për shkak të gjendjes të dal në bjeshkë dhe për këtë arsye edhe e ka ndërtuar, ka bërë përpjekje për sigurimin e lejes ndërtimore e pas që e ka kuptuar se është e nevojshme leja ndërtimore dhe nuk e ka marrë lejen dhe nuk e ka marr lejen dhe se nuk ka qenë i vetëdijshëm se është shkelje aq e rëndë kërkoj nga Gjykata që ti shqiptoj një dënim me të butë dhe nëse ekziston mundësia dhënëse e parasheh Ligji, të liroj nga shpenzimet e procedurës sepse është prind i dëshmorit ”.

I pandehuri H. F. deklaroi “ Pajtohem me deklarinimin e avokateve dhe nuk kam çka të shtoj tjetër ”.

#### B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42,43, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese te çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit gjorbë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti si dhe dënim me gjorbë në lartësi prej 500 (pesëqind) euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk kryen veprën tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin nuk kemi fare rrethana renduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dënimin më gjorbë gjykata e shqiptoj duke u bazuar në faktin se për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë shqiptimin e dënimit me gjorbë dhe me burgim në mënyrë kumulative, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 43 par.1 dhe 2 të KPRK-së vendosi që të pandehurit t'i shqiptoj dënimin me gjorbë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, më bindjen se ky dënim së bashku me dënimin me burgim, do të arrijnë në mënyrë të mjaftueshme të shprehin gjykimin shoqëror për veprën e kryer.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimeve gjykata u bazua në nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurit H. F. do të arrihet të realizohet në tersi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurit, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit. Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej dy (2) vitesh do të kryej veprën tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënim me burgim dhe gjorbë si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandaloj të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet “Dënim me kusht mund t'i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënim me burgim deri në pesë (5) vjet”, e në këtë rast siç u përshkrua me lartë për veprën penale

qe është shpallur fajtor i pandehuri është paraparë mundësia e shqiptimit të dënimit me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit H. F. është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Kur u vendos për rrënimin e objektit të ndërtuar pa leje e te përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi në bazë të nenit 359 par.5 të KPRK-së ku është paraparë se “Ndërtimi pa leje në këtë nen duhet të rrënohet dhe shpenzimet e rrënit barten te kryesi”, pra dispozita materiale ka paraparë qe objekti i ndërtuar pa leje duhet qe të rrënohet dhe kjo nuk është dispozitë alternative për gjykatën për është normë obligative.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjorë nga neni 364 dhe 369 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.617/22, me datë 20.03.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale:  
Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues:  
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.